

LIGJI NR. 08/L-149

PËR NDRYSHMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-010 PËR NOTERINË

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-010 PËR NOTERINË

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë për rregullimin e kompetencës së ministrit në caktimin e kompetencës territoriale të noterëve të cilët ushtrojnë profesionin e noterit në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Në nenin 8 të Ligjit Bazik pas paragrafit 5. shtohen paragrafët si në vijim:

6. Përfundimisht nga paragrafi 2. i këtij neni, në rastet kur ka mungesë të noterit në territorin e caktuar, ministri me vendim mund të caktojë noterin e një territori tjetër që të kryejë shërbime noteriale në komunën e caktuar.

7. Shërbimet noteriale në territorin tjetër sipas paragrafit 6. të këtij neni, ofrohen të paktën një (1) dhe jo më shumë se dy (2) ditë në javë në komunën përkatëse.

8. Shërbimet noteriale sipas paragrafit 6. të këtij neni ofrohen jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga nxjerrja e vendimit sipas paragrafit 6. të këtij neni.

9. Noteri i cili me vendim të Ministrit është caktuar për të kryer shërbime noteriale sipas paragrafit 6. të këtij neni do të vazhdojë punën edhe në territorin zyrtar të caktuar fillimisht.

10. Noteri i cili është caktuar për të kryeshërbime noteriale sipas paragrafit 6. të këtij neni duhet të plotësojë kushtet sipaskërkesave të këtij ligji dhe akteve të tjeranëligjore edhe për zyrën e re.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-149
8 nëntor 2022**

Shpallur me dekretin Nr. DL-328/2022, datë 21.11.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu